



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 87/15

Nr. i fq. / Br. st -14-

Data: / Datum 30.04.2015

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

RR E G U L L O R E
PËR KUSHTET E MBAJTJES SË QENVE DHE MACEVE, SI DHE MËNYRËN E
VEPRIMIT NË RAST TË BRAKTISJES OSE HUMBJES SË TYRE

Prill, 2015

Bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr.2004/21 për Veterinarinë, Nenin 4 dhe 5 të Ligjit Nr.02/L-10 për Përkujdesje ndaj Kafshëve, Nenin 12 paragrafi 2 pika (c) dhe Nenin 17 pika (s) të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale (GZ, nr. 28/15 qershor 2008), Nenin 41 paragrafi 2 pika (c) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 prill 2015**, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E
P Ë R
KUSHTET E MBAJTJES SË QENVE DHE MACEVE, SI DHE MËNYRËN E
VEPRIMIT NË RAST TË BRAKTISJES OSE HUMBJES SË TYRE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet dhe mënyrat e mbajtjes së qenve dhe maceve, mënyra e kontrollimit të shumimit të tyre, mënyra e mbajtjes së qenve të rrezikshëm, si dhe veprimet ndaj qenve dhe maceve të braktisura ose të humbura në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2
Përkufizimet

Përkufizimet në këtë rregullore kanë kuptimin e përkufizimeve të dhëna në Ligjin për përkujdesjen ndaj kafshëve, Ligjin për veterinarinë, ligjet dhe aktet tjera nënligjore, të cilat kanë zbatim ndaj qenve dhe maceve:

1. **“Mbajtës”** – mbajtës i një qeni apo maceje, është personi që është pronar apo që kujdeset dhe që është përgjegjës për rritjen, trajtimin, kujdesin dhe transportin e kafshës. Mbajtës është edhe pronari i objekteve për strehimin, rritjen, marketingun, transportimin apo kujdesin për qentë dhe macet. Mbajtësi është përgjegjës për qentë dhe macet që janë në kujdesin e tij apo të saj. Meqenëse komuna është përgjegjëse, konsiderohet mbajtëse e qenve dhe maceve të braktisura dhe përkujdeset për zënien, kujdesin, strehimin, d.m.th. mbajtjen e kafshëve të braktisura në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. **“I/e braktisur”**, ka kuptimin e qenit apo maces që është lënë qëllimisht nga mbajtësi për të hequr dorë prej tij/saj. Ky term u referohet edhe qenve dhe maceve që mbajtësit e tyre i lënë anash nga pakujdesia, si dhe qenve dhe maceve të gjetura apo të lëna nga pronari/ja.
3. **“I/e humbur”**, ka kuptimin e qenit apo maces që ka humbur pa dëshirën e mbajtësit, të cilin/cilën ai/ajo e kërkon.

4. **“Qen endacak”**, ka kuptimin e secilit qen, i cili nuk është në kontrollin e drejtpërdrejtë të mbajtësit ose nuk e pengon në lëvizje, që nënkupton edhe qentë e braktisur apo të humbur;
5. **“Qen i rrezikshëm”**, ka kuptimin e qenit, i cili pa qenë i provokuar, i shkakton njeriut apo kafshës lëndim ose i merr jetën, që është i rritur dhe i trajnuar për dyluftim me qentë tjerë.
6. **“Strehimore”** apo **“familje strehuese”**, ka kuptimin e strehimores në një komunë, qëllimi i së cilës është ofrimi i strehimit dhe kujdesit të përkohshëm qenve dhe maceve të braktisura dhe të humbura pas zënies së tyre.
7. **“AUV”**, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës.
8. **“Mikroçip”** ka kuptimin e një implanti të vendosur nën lëkurën e qenit apo maces, sipas standardeve të përcaktuara.
9. **“Sterilizimi”**, ka kuptimin e shterpëzimit (të bushtrave/maceve) dhe kastrimit (të qenve/maçokëve), për ta parandaluar shumimin enorm të qenve dhe maceve.
10. **“Veterinar”**, personi që i ka përfunduar studimet për veterinarin dhe i licencuar nga organi kompetent për ushtrimin e kësaj veprimtarie.
11. **“Teknik i veterinarisë”**, personi që e ka përfunduar shkollimin përkatës për veterinarin apo i trajnuar nga lëmi përkatës, dhe i licencuar nga organi kompetent për ushtrimin e veprimtarisë.
12. **“Qendra”**, ka kuptimin e qendrës së themeluar nga komuna për veprimet me qentë dhe macet në territorin e komunës.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 3

Kushtet dhe mënyra e mbajtjes së qenve dhe maceve

Mbajtësi i qenve dhe maceve është i obliguar të mbajë qentë dhe macet në përputhje me dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë mënyrën e mbajtjes dhe me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Ndalimi i mbajtjes së qenve dhe maceve që paraqesin rrezik

Në territorin e Komunës së Vushtrrisë është e ndaluar mbajtja e qenve dhe maceve të rrezikshme dhe atyre me potencial të rrezikut, të parapara me dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Neni 5

Mbajtja e qenve dhe maceve në objekte të përbashkëta publike

1. Mbajtja e qenve dhe maceve në hapësirat e përbashkëta të ndërtesave dhe oborreve, lëvizja e qenve dhe maceve, pastrimi i hapësirave nga fekalet etj., i përcaktojnë bashkëpronarët e ndërtesave, shfrytëzuesit e ndërtesave me pëlqimin e pronarit.
2. Në rast dyshimi të paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse, të cilat mund të barten nga qentë dhe macet te njerëzit, mbrojtjen e personave nga paragrafi 1 të këtij neni, e zbatojnë personat fizikë dhe juridikë, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë shëndetësore, private dhe publike, në bashkëpunim me organet kompetente të veterinarisë.

Neni 6

Kontrolli preventiv i qenve dhe maceve

1. Mbajtësi është i obliguar të bëjë kontrollimin e qenve dhe maceve, si dhe të sigurojë kushtet e parapara për mbajtje;
2. Mënyrat e kontrollimit të shumimit të qenve dhe të maceve, mund të jenë:
 - 2.1. Veprimtari preventive;
 - 2.2. Sterilizimi ose kastrimi i qenve dhe maceve.

Neni 7

Lëvizja e qenve dhe maceve në hapësirat publike

Lëvizja e qenve dhe maceve është e lejuar në hapësirat publike të lejuara nga pronari, shfrytëzuesi i hapësirës, në kushte të përcaktuara, nëse me këtë rregullore nuk është caktuar ndryshe.

Neni 8

Kufizimi i lëvizjes së qenve dhe maceve

1. Qentë dhe macet që lëvizin lirshëm ose në zinxhirë, lëvizjet e tyre janë të ndaluara në tregje, varreza, hapësira argëtuese të fëmijëve, lulishte, terrene sportive të parrethuara, pishina, oborre, hapësira të shkollave të parrethuara, si dhe vende të tjera publike, të cilat do të shenjzohen me shenjën e ndalesës për qentë dhe macet.
2. Shenjat nga paragrafi 1 i këtij neni, i vendos dhe i mirëmban drejtoria përkatëse e shërbimeve publike.

Neni 9
Lejimi i bartjes së qenve dhe maceve në transportin publik

Qentë dhe macet mund të lejohen të futen në mjetet e transportit publik, me leje të veçantë të organit kompetent për punët e shërbimeve publike.

Neni 10
Liria e lëvizjes së qenve të trajnuar

Kufizimi i lëvizjes së qenve sipas kësaj rregulloreje nuk do të zbatohet për qentë e trajnuar që ndihmojnë njerëzit me nevoja të veçanta.

Neni 11
Obligimet e mbajtësit të qenve apo maceve

1. Mbajtësi i qenve dhe maceve është i obliguar që për çdo lëvizje në sipërfaqe publike të komunës, të mbajë pajisjet për pastrimin e fekaleve - jashtëqitjeve dhe pastrimin e secilës hapësirë që këto kafshë e ndotin.
2. Fekalet - jashtëqitjet hidhen në vendet e caktuara të vendosura në hapësirat publike.
3. Punën e vendosjes, mirëmbajtjes dhe zbrazjes së shportave për fekalet – jashtëqitje e bën kompania komunale për pastrimin e mbeturinave.

Neni 12
Mënyrat, format dhe obligimet e mbajtësve të qenve dhe maceve

1. Qeni i cili mbahet në oborret e parrethuara apo kopsht, duhet të jetë i lidhur me zinxhir ose i vendosur në hapësirën e caktuar e cila është e siguruar që qeni nuk mund të jetë në gjendje të largohet.
2. Mbajtësit nuk i lejohet ta lidhë qenin me zinxhir, i cili është më i shkurtër se 3 metra, apo trefishin e gjatësisë së qenit, të matur nga maja e bishtit deri në majën e hundës.
3. Qeni i cili mbahet në oborret e rrethuara ose në kopshte, nuk ka nevojë të lidhet, me kusht që lartësia dhe fortësia e rrethojës ofrojnë siguri për kalimtarët.
4. Mbajtësi i cili mban qenin në mënyrën e paraparë në paragrafin 3 të këtij neni, në vendin e dukshëm duhet ta vendosë shenjën me të cilën paralajmëron për qen, dhe duhet të ketë zile në gjendje të rregullt në hyrje të oborrit apo të kopshtit.
5. Mbajtësi mund ta shëtisë qenin në hapësira publike, atëherë kur qeni është i pajisur me mikroçip dhe zinxhir.

6. Mbajtësi i qenit të rrezikshëm mund ta shëtisë qenin në sipërfaqet publike të caktuara nga organi kompetent për shërbime publike, i cili duhet të jetë i lidhur me zinxhir, i pajisur me mikroçip dhe mbrojtës për nofulla.

7. Organi kompetent për shërbime publike, bën caktimin e vendeve të cekura në paragrafin 2 të këtij neni, në afat prej gjashtë (6) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Mbajtja e maceve

1. Organizatat për mbajtjen e kafshëve, të cilave u lejohet ushqyerja e maceve, janë të obliguara që macet të jenë të kastruara, të vaksinuara, të pastruara nga parazitët dhe të shenjëzuara në bazë të rregullave të profesionistëve të veterinarisë.

2. Në rast të dyshimit të paraqitjes së sëmundjeve ngjitëse, të cilat barten nga macet te njerëzit, mbrojtja e qytetarëve ushtrohet nga personat fizikë dhe juridikë të veprimtarisë shëndetësore, në bashkëpunim me organet kompetente të caktuara me dispozitat e veprimtarisë veterinarë.

3. Nëse shoqatat e kafshëve nuk kujdesen për macet në mënyrën e përcaktuar si në paragrafin 1 të këtij neni, barrën e shpenzimeve të të ushqyerit e bart organizata.

Neni 14

Veprimi me qentë dhe macet e braktisura dhe të humbura

1. Mbledhjen, transportin dhe akomodimin e qenve dhe maceve të braktisura dhe të humbura e bën kompania e autorizuar/kontraktuar nga komuna.

2. Mbajtësi i kafshës së humbur është i obliguar që të njoftojë organin që mban regjistrin e qenve/maceve, në afat prej tri (3) ditësh.

3. Gjetësi i qenit/maces së braktisur apo të humbur, është i obliguar ta njoftojë organizatën dhe qendrën informative, si dhe t'i ofrojë ndihmë qenit/maces deri në kthimin e tij te mbajtësi apo të vendosjes në strehimore.

Neni 15

Kompensimi i dëmit të shkaktuar nga qentë dhe macet

Mbajtësi i qenve dhe maceve të braktisura apo të humbura, është i obliguar të kompensojë secilin dëm, të cilin e shkaktën qeni apo macja nga momenti i braktisjes apo humbjes deri te momenti i kthimit te mbajtësi apo organizata për strehim.

Neni 16

Themelimi i strehimores

1. Të gjithë pronarët e strehimoreve për qenë dhe mace, duhet të regjistrohen në AUV, në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës, dhe AUV do të njoftojë komunën për themelimin e tyre;
2. Komuna njofton publikun për strehimoret që operojnë në territorin e saj.
3. Strehimorja të plotësojë kushtet si:
 - 3.1. Strehimorja të jetë jashtë qytetit dhe së paku 500 m larg vendbanimeve, objekteve shkollore, kulturore dhe fetare;
 - 3.2. Të ketë sipërfaqe prej 0.30 ha dhe rrethojë të objektit në lartësi prej 2 m;
 - 3.3. Të jetë i kyçur në sistemin e kanalizimit ose së paku të ketë gropë septike, ku ujërat e zeza dhe fekalet nuk depërtojnë në ujin nëntokësor;
 - 3.4. Të sigurojë ujë të mjaftueshëm për pije dhe nevoja tjera të strehimores;
 - 3.5. Të ketë mbulojë në vende të caktuara në mënyrë që të krijojë mundësi të përshtatshme jetese për mbrojtje nga kushtet klimatike (reshjet, rrezet e diellit) etj;
 - 3.6. Të ketë në posedim një objekt adekuat me sipërfaqe së paku 4x4m dhe 2m lartësi në oborrin e strehimores ose diku tjetër, ku do të kryhen aktivitete veterinarë si: sterilizimi/ kastrimi, vendosja e mikroçipit ose numri i matkulimit dhe eutanazia etj.

Neni 17

Përgjegjësitë e strehimores

1. Pronarët e strehimoreve për qenë dhe mace kryejnë detyrat si në vijim:
 - 1.1. Pranojnë dhe i regjistrojnë raportimet për qentë dhe macet e braktisura apo të humbura;
 - 1.2. Përkujdesen për zënien, transferimin, akomodimin dhe kujdesin e dinjitetshëm për qentë dhe macet e braktisura apo të humbura në strehimore;
 - 1.3. Sigurojnë ndihmë veterinarë qenve dhe maceve të braktisura apo të humbura;
 - 1.4. Bëjnë sigurimin e qenit apo maces së braktisur në strehimore, i ofrojnë akomodim dhe kujdes, si dhe evidentojnë vendin ku është marrë (emrin dhe informatat për kontaktim të personit që e ka dorëzuar), përshkrimin dhe kushtet e tij.

2. Personeli i strehimores përcakton nëse qeni apo macja i përket dikujt dhe raporton me një përshkrim të atij qeni apo asaj maceje, si dhe të vendndodhjen aktuale të tij/saj, e cila do ta bëjë informatën publike përmes ueb-faqes së saj apo përmes ndonjë mjeti tjetër të përshtatshëm:

2.1. Në afat prej 48 orëve pas pranimit në karantinën e cilësdo strehimore, çdo qeni apo maceje i siguron kontroll fillestar nga një veterinar;

2.2. Veterinari vërteton nëse qeni apo macja është sterilizuar dhe nëse të gjitha vaksinat janë aktuale. Nga të dhënat në mikroçip apo etiketë, ndonjë zyrtar i strehimores kontakton pronarin për ta marrë qenin apo macen. Para se t'ia kthejë kafshën pronarit të saj, strehimorja i azhurnon vaksinat e qenit apo maces. Nëse qenit nuk i është vënë mikroçip, strehimorja e shënjon atë me një mikroçip dhe e regjistron në bazë të të dhënave. Strehimorja i ofron sterilizim apo kastrim kafshës, me shpenzimet e mbajtësit/pronarit. Mbajtësi/pronari i qenit apo maces ngarkohet me një tarifë, për t'i mbuluar shpenzimet e kujdesit për qenin apo macen nga ana e strehimores dhe për t'i inkurajuar mbajtësit që t'i mbajnë në kontroll qentë dhe macet e tyre. (Herën e dytë, kur qeni apo macja e pastertilizuar gjendet e braktisur nga pronari i saj, ajo do të sterilizohet apo kastrohet nga veterinari i strehimores me shpenzimet e mbajtësit);

2.3. Nëse qenit apo maces nuk i është vënë çipi dhe nëse pronari nuk mund të lokalizohet, veterinari do t'ia japë vaksinat dhe do ta caktojë kafshën për sterilizim, nëse moshja dhe shëndeti i saj e lejojnë këtë. Qeni ose macja do të vendoset në mesin e kafshëve të tjera të strehimores, pas një karantine të kërkuar prej dhjetë (10) ditësh;

2.4. Nëse asnjë pronar apo mbajtës nuk pretendon se qeni apo macja është e tij, strehimorja njofton për bërje publike që qeni apo macja është në dispozicion për adaptim. Qenit apo maces do t'i vihet mikroçip dhe do të vaksinohet, sterilizohet, apo kastrohet para se të jetë në dispozicion për adaptim. Strehimorja bën regjistrimin e informatave për pronarin e ri, në bazën e të dhënave të regjistrimit në mikroçip, para se t'ia japë kafshën pronarit;

2.5. Staf i strehimores çdo ditë vëzhgon secilin qen dhe mace në kujdesin e tij dhe lajmëron veterinarin për ndonjë keqësim eventual të gjendjes shëndetësore;

2.6. Mban evidencë për të gjithë qentë dhe macet. Pasi ta marrë kafshën, strehimorja mban evidencë për vendin ku ajo është marrë (emrin dhe informatat për personin që e ka dorëzuar kafshën), përshkrimin fizik dhe gjendjen shëndetësore të saj, si dhe çfarëdo trajtimi që i ofrohet asaj. Në rast se ndonjë kafshë largohet nga strehimorja, shënohet emri dhe vendi i personit që e merr atë, së bashku me çdo tarifë me të cilën ai ngarkohet;

2.7. Mban evidencë për të gjitha tarifat e ngarkuara në lidhje me kafshët e braktisura dhe ia kthejnë ato komunës;

2.8. Mbajtësit e strehimoreve për qentë dhe macet, duhet t'u përmbahen të gjitha

kërkesave të kësaj rregulloreje që ka të bëjë me mbajtësit e qenve dhe maceve;

2.9. Strehimorja e ngarkon mbajtësin e qenit apo të maces, me të gjitha shpenzimet e bëra në lidhje me ndonjë kafshë të braktisur, përveç nëse me këtë rregullore parashihet ndryshe. Nëse strehimorja ia jep qenin apo macen e braktisur një pronari/mbajtësi të ri, strehimorja mund ta ngarkojë mbajtësin e ri me një paushall për shpenzimet materiale.

3. Pronari i strehimores i siguron mjetet për themelimin e strehimores edhe nga burimet si në vijim:

3.1. Tarifat për shpenzimet në lidhje me kafshët e braktisura dhe regjistrimin e qenve;

3.2. Burimet e tjera (dhuratat, donacionet etj.), të cilat evidentohen dhe raportohen.

Neni 18 **Qendra strehimore**

1. Në qendrat strehimore, strehohen qentë dhe macet në mënyrën si vijon:

1.1. Qentë dhe macet e humbura deri në kthimin të mbajtësi i tyre;

1.2. Qentë dhe macet e braktisura, për të cilat nuk mund të vërtetohet identiteti i mbajtësit;

1.3. Qentë dhe macet për të cilat mbajtësi i tyre nuk mund të sigurojë kushtet e parapara për mbajtjen e tyre.

2. Shpenzimet e vendosjes në qendër të cekur në paragrafin 1 të këtij neni, i bart mbajtësi i qenve dhe maceve, kurse shpenzimet e qenve dhe maceve të cekura në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 të këtij neni, i bart organi përkatës komunal.

Neni 19 **Regjistrimi i detyrueshëm i qenve dhe maceve**

1. Të gjithë mbajtësit e qenve dhe maceve duhet t'i kenë qentë dhe macet e tyre të shënjuar nga veterinarin me mikroçip, të dhëna që duhet t'i ketë edhe komuna. Shpenzimet për shënjim janë përgjegjësi e mbajtësit. Mikroçipi që mund të lexohet në mënyrë elektronike, duhet të jetë në përputhje me standardet e BE-së, ndërsa të dhënat që regjistrohen aty, duhet të jenë në përputhje me standardet e përshkruara në këtë rregullore. Baza e të dhënave mbahet sipas ligjeve në fuqi për:

1.1. Qëllim të kthimit të qenve ikanakë, të braktisur apo të lënë prapa tek pronarët e tyre, pronarët e qenve sigurojnë që qentë e tyre jenë të shënjuar nga veterinarin me çip elektronik. Pronarët e qenve po ashtu e fiksojnë një etiketë të qartë dhe lehtësisht të lexueshme në kollaren e qenit të tyre, me informata për emrin dhe numrin e telefonit të pronarit;

1.2. Pronarët privat të qenve sigurojnë që qentë e tyre jenë të shënjuar me çip elektronik dhe etiketë në kollare, siç është përshkruar më lart. Shitësit e qenve, pronarë dhe tregtarë, konsiderohen mbajtës privat;

1.3. Operatorët e strehimoreve të qenve do t'i shënjojnë ato nën kujdesin e tyre me çip elektronik, siç është përshkruar më lart, si dhe me një shenjë të dytë, siç është ndonjë etiketë veshi;

1.4. Pronarët e qenve të rritur janë përgjegjës për të siguruar që kjo të ndodhë brenda një muaji pasi ta kenë marrë një qen, apo brenda një muaji pasi ta kenë sjellë një qen në strehimore;

1.5. Pronarët e këlyshëve janë përgjegjës për të siguruar që regjistrimi i tyre do të bëhet para moshës tremujsh (3) dhe në cilindo rast, para se pronësia mbi ta të bartet për herë të parë;

1.6. Qentë e pajisur me mikroçip, të cilët merren jashtë territorit të komunës sonë, nuk kërkohet që të shënjojnë përsëri, por të dhënat në mikroçip duhet të azhurnohen në komunë me të dhënat e mbajtësit të ri. Të dhënat për qentë që qëndrojnë në territorin e komunës për më pak se katër (4) muaj, nuk kërkohet që të azhurnohen, por mund të azhurnohen (ky përjashtim nuk vlen për qentë që mbahen nga dyqanet e qenve nga pronari, shitësi apo tregtari i qenve).

2. Qendra krijon bazën e të dhënave për regjistrimin dhe udhëheqjen e të dhënave. Komuna do t'i publikojë procedurat për veterinarët e Kosovës, duke e përdorur bazën e të dhënave. Baza e të dhënave do të përdoret për t'i udhëhequr të dhënat, të cilat veterinarët do t'i regjistrojnë kur t'ia vënë qenit mikroçipin. Në këto të dhëna do të hyjnë:

2.1. Të dhënat personale të mbajtësit, emri dhe informatat për kontaktim;

2.2. Karakteristikat e qenit: raca, gjinia, është i shterpëzuar apo kastruar, data e lindjes, shënjimimin (numrin e mikroçipit), vërejtjet lidhur me çfarëdo ndryshimi të pazakonshëm në pamjen e qenit, data e vaksinës së fundit kundër tërbimit dhe numri i identifikimit të vaksinës, si dhe numri i pasaportës së BE-së.

3. Veterinari i regjistron të dhënat e qenit, nëse kërkohet edhe të maces dhe të pronarit në kohën kur i vihet mikroçipi. Veterinari mbledh tarifën komunale, siç është përshkruar në nenin 27 të kësaj rregulloreje, dhe tarifa me informatë i dorëzohet komunës.

4. Dyqanet, shitësit, tregtarët e qenve dhe strehimoret duhet të nisin t'i shënjojnë dhe regjistrojnë qentë jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 20

Transportimi i qenve dhe maceve

1. Qentë dhe macet mund të transportohen brenda vendit, nga një lokacion në tjetrin apo jashtë vendit, vetëm nëse qeni ose macja është:

- 1.1. i/e pajisur me certifikatë të lëshuar nga AUV-ja;
- 1.2. identifikuar me shenjë identifikimi ose dokumentin e paraqitur në certifikatë;
- 1.3. nuk është përfshirë në kushtet dhe kufizimet, të cilat AUV i konsideron të duhura për zbatim;
- 1.4. transporti është në përputhje me dispozitat e përcaktuara ligjore;

2. Lidhur me kushtet dhe mënyrat e transportit të qenve dhe maceve, do të zbatohen dispozitat ligjore për transportin e kafshëve në mënyrë analoge.

Neni 21

Mbarështimi i qenve dhe maceve

1. Mbarështimi i qenve dhe maceve bëhet me metodat e mbarështimit, sipas llojit dhe kategorisë së tyre, në mënyrë që të njëjtat të përdoren për parandalimin e mbarështimit të pakontrolluar;
2. Me qëllim të zvogëlimit të shumimit të qenve dhe maceve endacake, të rrezikshme dhe atyre të papërshtatshme, përcaktohet steriliteti i obliguar i tyre;
3. Personi i përfshirë në mbarështimin e qenve dhe maceve është përgjegjës për ruajtjen e karakteristikave anatomike dhe fiziologjike dhe të sjelljes së qenve dhe maceve, të cilat mund të vënë në rrezik shëndetin apo mirëqenien e të vegjëlve apo prindërve të tyre.

Neni 22

Qentë dhe macet për eksperimente

Lidhur me përdorimin e qenve dhe maceve për eksperimente, do të zbatohen dispozitat e ligjit dhe aktet nënligjore për eksperimente me kafshë.

Neni 23

Shfrytëzimi i qenve dhe maceve për gara

1. Qenët dhe macet mund të shfrytëzohen për gara.
2. Përjashtim bën organizimi i garave, ku testohet shpejtësia apo fuqia e qenit dhe maces, në ç'rast mund të pësojë dhimbje, lëndime apo ngordhje, dhe mund të lejohen vetëm në rastet kur kjo është në pajtim me dispozitat ligjore, aktet nënligjore dhe në kontrollin e veterinarit të AUV-së.

3. Çështjet tjera që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e qenve dhe maceve rregullohen me aktin nënligjor që ka të bëjë me rekreacionin, garat, sportin, stërvitjen, edukimin, ekspozimin publik, shfaqjen etj.

Neni 24 **Vrasja e qenve dhe maceve**

1. Ndalohet vrasja e qenve dhe maceve pa arsye të duhur.
2. Ndalohet vrasja e qenve dhe maceve me qëllim të prodhimit të ushqimit apo produkteve të tjera.
3. Pa i paragjykuar ndalesat që janë paraparë me paragrafët 1 dhe 2, vrasja e qëllimshme e qenve dhe maceve lejohet që të bëhet vetëm nga veterinarët e licencuar. Kjo mund të bëhet vetëm në një mënyrë veterinare profesionale që quhet eutanazi. Kryesisht, kjo do të bëhet vetëm në këto raste, kur:
 - 3.1. Qeni apo macja është në agoni, ka sëmundje të pashërueshme apo është e lënduar rëndë, ndërsa sëmundja apo lëndimi i shkakton kafshës vuajtje të jashtëzakonshme;
 - 3.2. Qeni apo macja e rrezikon mjedisin apo shkakton dëm të konsiderueshëm, i cili nuk mund të parandalohet ndryshe;
 - 3.3. Qeni apo macja e ka arritur një moshë, në të cilën funksionet vitale të saj janë dobësuar shumë;
 - 3.4. Nëse qeni apo macja është mbajtur në strehimore të kafshëve për katërdhjetë e pesë (45) ditë, i/e njëjta nuk mund të lirohet (për shkak të shëndetit të përkeqësuar apo rrezikut që mund ta shkaktojë), por as nuk janë kërkuar për adaptim, ndaj tij/saj mund të aplikohet eutanazia në mënyrë që të krijohet hapësirë e mjaftueshme për vendosjen (strehimin) e qenve dhe maceve të tjera të braktisura.
4. Lejohen vetëm masat dhe procedurat veterinare profesionale të vrasjes së qenve dhe maceve.
5. Vrasja e paramenduar e ndonjë qeni apo maceje që kryhet në kundërshti me ligjin e Kosovës dhe me këtë rregullore, konsiderohet vepër penale.
6. Nëse trajtimi i përmendur në paragrafët 1, 2 dhe 3, të këtij neni, kryhet ndaj një qeni të policisë, kjo shkelje do të konsiderohet veçanërisht e rëndë, si dhe do të referohet për ndjekje penale nga organet kompetente.

Neni 25 Tarifat

1. Tarifa vjetore për regjistrimin e qenve dhe maceve:

1.1. Qentë, macet (e pakastruar/të pasterilizuar/) tridhjetë (30) €;

1.2. Qentë, macet (të kastruar/të sterilizuar/) pesë (5) €;

2. Tarifa e caktuar në paragrafin 1 të këtij neni, paguhet në momentin e regjistrimit të qenit apo maces dhe është e hyrë komunale.

3. Tarifat që mbliidhen për shpenzimet e strehimores do t'i shtohen buxhetit të strehimores drejtpërdrejt.

4. Tarifat që mbliidhen si gjoba komunale do të përdoren për mbulimin e shpenzimeve të strehimores nga komuna.

5. Të gjitha tarifat e mbledhura nga strehimorja apo veterinari, do të evidentohen dhe do t'i raportohen qendrës.

Neni 26 Gjobat

1. Për mosregjistrimin e qenit apo maces nga ana e pronarëve privat brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, gjoba është njëzet e pesë (25) €.

2. Për mosmbajtjen e qenit ose maces në kontroll apo mospërmbajtja e maces së pasterilizuar gjatë periudhës së pjellorisë, gjoba është njëzet e pesë (25) €, për përsëritje të shkeljes, pesëdhjetë (50) €.

3. Strehimorja që e ka mbajtur qenin apo macen me pronar, do ta ngarkojë pronarin e saj me shpenzimet e strehimores, së bashku me një tarifë komunale:

3.1. Shkelja e parë: shpenzimet e vaksinimit, vënia e mirkoçipit (që duhet të mbahet nga strehimorja) plus njëzet e pesë (25) € (tarifa komunale);

3.2. Shkeljet e pastajme: shpenzimet e vaksinimit, vënia e mirkoçipit dhe shterpëzimi (që duhet të mbahen nga strehimorja), plus pesëdhjetë (50) € (tarifa komunale).

4. Për shkeljet e nenit 12 mund të caktohet gjobat komunale prej 25 – 500 € dhe krahas kësaj:

4.1. Mosmbajtja në litar – pesëmbëdhjetë (15) €;

- 4.2. Mospastrimi – pesëmbëdhjetë (15) €;
- 4.3. Mosvaksinimi- njëzet e pesë (25) €;
- 4.4. Mospërmbajtja e qenit të rrezikshëm – njëqind (100) €;
- 4.5. Shitja ilegale e qenve dhe maceve – njëqind (100) €.

Neni 27

Qendra e veprimit për qenet dhe macet

1. Komuna do të themelojë Qendrën e veprimit për qentë dhe macet.
2. Detyrat e qendrës janë:
 - 2.1. Të hapë një linjë telefonike të pandërprerë, një adresë të postës elektronike dhe një web-faqe të Qendrës së veprimit për qenë dhe mace, për mbledhjen e informatave nga qytetarët dhe përhapjes së informatave tek ta.
 - 2.2. Linja telefonike e pandërprerë dhe adresa e postës elektronike, mund të përdoren nga qytetarët për t'i raportuar problemet me qenë dhe mace. Qendra do të mbajë evidencë të thirrjeve dhe porosive elektronike që janë pranuar dhe veprimeve që janë marrë.
 - 2.3. T'i emërojë dy zyrtarë të mirëqenies së kafshëve për t'iu përgjigjur shqetësimeve të qytetarëve që nuk janë të përshtatshme për reagim nga ana e policisë dhe për të ndihmuar në inspektimin e strehimoreve të kafshëve dhe të shtëpive, në të cilat raportohen probleme me ndonjë mace apo qen.
 - 2.4. Ta bashkërendojë çdo kërkesë të përshtatshme me AUV-in.

Neni 28

Mbikëqyrja dhe zbatimi

1. Zbatimin e kësaj rregulloreje e bëjnë Inspektorët e veterinarisë në kuadër të komunës, Inspektorët komunal të shërbimeve publike, Inspektorët për mbrojtje të mjedisit dhe Policia e Kosovës.
 - 1.1. Inspektori i veterinarisë kryen mbikëqyrjen e zbatueshme të neneve: 3, 4, 5, 6, 7, 9, 10, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 24.
 - 1.2. Inspektori i shërbimeve publike dhe Inspektori për mbrojtje të mjedisit kryen mbikëqyrjen e neneve 8 dhe 11 të kësaj rregulloreje.

1.3. Policia e Kosovës zbaton nenet: 8, 11, 12 dhe 23 të kësaj rregulloreje, si dhe asistojnë inspektorët.

Neni 29 **Dispozitat ndëshkimore**

1. Personi fizik do të gjobitet për kundërvajtje me gjobë në shumë prej 50 deri në 100 € nëse:

1.1. Shëtit qenin apo macen në sipërfaqet publike ku është e ndaluar lëvizja;

1.2. Nuk bart pajisjet për pastrimin e fekaleve - jashtëqitjeve dhe nuk bën pastrimin e sipërfaqes të cilën qeni apo macja e ndot;

1.3. Shëtit qenin në sipërfaqe publike pa zinxhir.

2. Prindi i fëmijës, i cili në kohën e kryerjes së kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk ka mbushur moshën 14 vjeçare, nëse ajo kundërvajtje është në lidhje të drejtpërdrejtë që ka prindi ose kujdestari me fëmijën, do të gjobitet për kundërvajtje me gjobë në shumën prej 30 deri në 60 €.

3. Inspektori komunal do të shqiptojë gjobën mandatore në shumë prej 25-100 €, për shkeljet e parapara në nenin 26 të kësaj rregulloreje.

Neni 30 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit